



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 328/ prot.

Tiranë, më 3.2.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje

QENDRA RESPUBLICA

Z. DORIAN MATLIJA, DREJTOR EKZEKUTIV

Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Ndërtesa 24. H.3, Ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ardhur në posten elektronike të koordinatores për të drejtën e informimit më datë 26.1.2023, protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 328 prot., datë 27.1.2023, ju bëjmë me dije se:

SPAK ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. *** prot., datë 24.05.2022, për fillimin e procedimit penal ndaj komisioneres znj. Etleda Çiftja.

Ky procedim penal ka përfunduar me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila vendosi: "Lënien në fuqi të vendimit nr. 48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", ku anëtarja e KPK-së, znj. Etleda Çiftja është shpallur e pafajshme.

Në lidhje me pyetjen tuaj të fundit, ju informojmë se, që nga fillimi e deri në përfundimin e këtij procesi, nuk ka asnjë vendim pezullimi për znj. Çiftja.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

